

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 622 Prot.

Tiranë, më 10.062016

VENDIM Nr. 61, datë 08.06.2016

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.7 të datës 08.06.2016, pasi shqyrtoi Raportin e Vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor në kuadër të *projektit "Resort turistik me një kompleks banesash 2 katëshe dhe 2 kat nëntokë" Gjilekë, Dhërmi -subjekti "Familja Begaj"*, realizuar nga shoqëri e licencuar në arkeologji "AKeR" sh.p.k.

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e Vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor në kuadër të *projektit "Resort turistik me një kompleks banesash 2 katëshe dhe 2 kat nëntokë" Gjilekë, Dhërmi -subjekti "Familja Begaj"*, realizuar nga shoqëri e licencuar në arkeologji "AKeR" sh.p.k.
2. Gjatë zbatimit të punimeve të realizohet mbikqyrja arkeologjike nga DRKK Vlorë, e cila duhet të depozitohet pranë Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik dokumentacionin për të, duke lidhur më parë akt-marrëveshje tre palëshe me ASHA dhe investitorin "Familjen Begaj", sipas vendimit të KKA Nr. 102, datë 1.09.2015.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO-FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Rudina Zoto", is written below the printed name of the Secretary of the Technical Secretariat.